



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 307, Datë 30.10.2023

MBI

REFUZIMIN E KËRKESËS SË SHOQATËS “AREA” PËR RISHIKIMIN VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-S NR. 27, DATË 16.02.2023 “MBI ÇMIMIN E APLIKUESHËM TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE QË DO T’U PAGUHET PRODHUESVE EKZISTUES ME PËRPARËSI ME HYRJEN NË FUQI TË VKM-SË NR. 67, DATË 08.02.2023”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 33, pika 2 dhe 180, pika 1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 67, datë 08.02.2023 “Për një ndryshim në Vendimin nr. 687, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes të energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, të ndryshuar; neneve 15 dhe 16 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.10.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 930/33 prot., datë 27.10.2023, të përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve “Mbi kërkesën e shoqatës AREA “Për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 27, datë 16.2.2023 “Mbi çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 67, datë 08.02.2023”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 129, datë 07.04.2023 ndër të tjera vendosi: (1) Të pranojë shqyrtimin e kërkesës së shoqatës “AREA” për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 27, datë 16.02.2023 “Mbi çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 67, datë 08.02.2023”; dhe (2) Të pezulloje afatin për marrjen e vendimit përfundimtar në lidhje me kërkesën e shoqatës “AREA”, për rishikimin vendimit të bordit të ERE-s nr.27, datë 16.02.2023 “Mbi çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 67, datë 08.02.2023”.
- Në vijim të vendimmarrjes përfundimtare mbi kërkesën e shoqatës “AREA”, bordi i ERE-s me vendimin nr. 302 datë 23.10.2023 vendosi mbi: (1) Shfuqizimin e pikës 2 të vendimit të bordit të ERE-s, nr. 129 datë 07.04.2023, (2) Pranimin e kërkesës së shoqatës AREA për shtyrjen e vendimmarrjes përfundimtarë të bordit të ERE-s mbi “Mbi kërkesën e shoqatës

“AREA” për rishikimin vendimit të bordit të ERE-s nr. 27, datë 16.02.2023 “Mbi çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 67, datë 08.02.2023”. (3) Bordi ERE-s do të shprehet brenda 30 ditëve kalendarike mbi kërkesën e shoqatës AREA “Për rishikimin vendimit të bordit të ERE-s nr. 27, datë 16.02.2023 “Mbi çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 67, datë 08.02.2023”.

1. Me shkresën nr. 1810/189 prot., datë 23.10.2023 të shoqatës “AREA”, u kërkuar (i) shtyrja e vendimmarrjes për shkak të pamundësisë të jetë prezent si dhe (ii) vënia në dispozicion të diskutimeve të seancës dëgjimore teknike datë 04.10.2023, nga ERE u vlerësua të shtyhet vendimmarrja “Mbi kërkesën e shoqatës “AREA” për rishikimin vendimit të bordit të ERE-s nr. 27, datë 16.02.2023 “Mbi çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 67, datë 08.02.2023” me qëllim garantimin e të drejtës së palës ankuese për t’u dëgjuar por edhe për sigurimin e provave të nevojshme që palët kërkojnë gjatë një procedure administrative, si dhe shqyrtimin e këtij dokumentacioni për të dalë më pas me një propozim përfundimtar, në lidhje me kërkesën e shoqatës “AREA.
- Në vijim të kërkesës së shoqatës “AREA”, vendimit të bordit të ERE-s nr. 129, datë 07.04.2023 “Për pranimin e shqyrtimit të kërkesës së shoqatës “AREA” “Për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 27, datë 16.2.2023 “Mbi çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 67, datë 08.02.2023”, korrespondencave të mbajtura me MIA-n me shkresën tonë nr. nr. 930/5 prot., datë 13.03.2023, kthim përgjigje nga MIE me shkresën nr. 2750/1 prot., datë 12.04.2023 dhe për sa diskutuar në seancat dëgjimore datë 29.09.2023 dhe datë 04.10.2023 rezulton se:
 - Lidhur me argumentin krahasues të shoqatës “AREA” se: *vendimmarrja e ERE-s për VKM-në nr. 398, datë 09.06.2022 ka fuqi prapavepruese ndërkohë vendimmarrja ERE-s, e datës 16.02.2023 nuk ka ruajtur të njëjtin standard në lidhje me përcaktimin e afateve të hyrjes në fuqi të akteve, vlerësojmë se ky fakt nuk përbën provë të re dhe është argumentim i gabuar. ERE gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishikimin e vendimmarrjes është mbështetur si në nenin 82 e në vijim të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, edhe në ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, konkretisht në nenin 98, pikat 1 dhe 2 dhe aktet nënligjore në zbatim të ligjit sektorial. Rezulton se ERE është shprehur përpara hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 398/2022 duke përcaktuar dhe fuqinë juridike të vendimmarrjes në lidhje me Vendimin nr. 106 datë 02.07.2020 “Mbi miratimin e rregullave të tregut shqiptarë të balancimit të energjisë elektrike” i ndryshuar.*

- Për sa i përket argumentit të shoqatës “AREA” për natyrën vjetore të çmimit të energjisë elektrike, vlerësojmë se hyrja në fuqi e akteve normative me botimin e tyre në Fletoren Zyrtare është një rregullim kushtetues dhe si i tillë nuk mund të mos respektohet. Në rastin konkret vetë VKM nr.67, datë 08.02.2023 ka përcaktuar hyrjen në fuqi të aktit i cili përkon me datën e publikimit në fletoren zyrtare dhe në vijim ERE është shprehur për afatin e hyrjes në fuqi me të njëjtën datë sipas publikimit në Fletoren Zyrtare (QBZ) sipas vendimmarrjes së ERE-s nr. 27, datë 16.02.2023. Vetë akti administrativ, VKM nr. 67/2023 është mbështetur në nenin 22, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, ku konkretisht neni 22/2 specifikon se: “Çmimi i blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit me përparësi,...llogaritet nga ERE, në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit.” Gjithashtu theksojmë se Neni 112, pika 1, shkronja “b” e Kodit të Procedurave Administrative ndër të tjera parashikon se: *Aktet administrative kanë fuqi prapavepruese... kur akti nxirret në zbatim të një vendimi gjyqësor, i cili nga ana e tij ka deklaruar të pavlefshëm një akt administrativ.* Ndërkohe vlerësojmë se përcaktimet e KPA janë të qarta dhe shteruese në lidhje me hyrjen në fuqi të një aktit administrativ, sipas parashikimit të Nenit 111 të Kodit të Procedurave Administrative i cili shprehet se: *“Aktet administrative hyjnë në fuqi nga dita e miratimit të tyre, me përjashtim të rasteve kur ligji ose vetë akti i jep atij fuqi prapavepruese ose të vonuar.”*
- Sa i përket relacionit të Projekt Vendimit të Këshillit të Ministrave dhe përcaktimeve të kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike dhe deklarimeve publike të MIE-s, sqarojmë se: në asnjë rast të konsultimit të aktit administrativ (VKM) apo ndonjë komunikim tjetër shkresor nuk është shprehur vullneti i hartuesit të aktit administrativ (MIE) mbi hyrjen në fuqi të këtij akti duke përcaktuar ndonjë periudhë që përfshin hyrjen në fuqi në janar 2023. Gjithashtu sqarojmë se fakti që pala kërkuese konsideron si provë të re “Deklaratën publike”, gjykojmë se deklaratat nuk mund të përbëjë prove të re dhe as shkak për një vendimmarrje të re të bordit të ERE-s. ERE bazohet në vendimmarrjen e saj në legjislacionin në fuqi si dhe në prova dhe fakte.
- Në vijim të diskutimeve në lidhje me periudhën e hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 67, datë 08.02.2023, MIE ndër të tjera konfirmon se: *i referohen akteve, vendimit të Këshillit të Ministrave, relacionit, efekteve që janë parë kur është miratuar ky akt. Ne jemi të hapur për diskutim dhe për mendimet e palëve deri në marrjen e një vendimi.... [si dhe nuk mund të shprehet ndryshe për periudhën për janar 2023].*
- Në mbështetje të interpretimit ligjor, vlen të përmendim dhe vendimin e Gjykatës së Lartë datë 04.02.2022, për shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen administrative me nr. 1830/2016, që u përket palëve: (i) paditës: Shoqata Shqiptare e Energjisë së Rinovueshme “AREA”, (ii) të paditur: Enti Rregullator i Energjisë, (iii) me objekt; *Deklarimin e pavlefshmërisë së vendimit të ERE, nr. 156 datë 24.12.2015, "Mbi lënien në fuqi të vendimeve nr. 139, nr. 140, nr. 141, nr. 145, nr. 146, nr. 147, nr. 148 datë 26.12.2014, si dhe të vendimit nr. 27 datë 16.02.2015 të Bordit të Komisionerëve të ERE për periudhën 1 janar - 30 qershor 2016.*

- Për sa argumentuar, vlerësojmë se pala ankuese nuk ka plotësuar kërkesat e ligji nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, i cili ka parashikuar në nenin 16, pika 5 se *“çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit lidhur me atë procedurë, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara”*.
- ERE në vendimmarrjen konkrete ka marrë në konsideratë edhe parashikimet e ligjit në mbrojtje të interesit të konsumatorëve sipas parashikimeve të ligjit sektorial nr. 43/2015 i ndryshuar seksioni III neni 12 gërma “d” ku parashikohet qartë se një nga detyrat dhe përgjegjësitë e ERE-s janë : *[angazhimi në zhvillimin e një sistemi të sigurt, të qëndrueshëm, jo diskriminues dhe në mbrojtje të konsumatorit]*.
- Gjithashtu, vlerësohet se argumentimi i palës kërkuese nuk ka përmbushur kushtin thelbësor të parashikuar në nenin 16, pika 1 të *“Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 03.09.2016, për sa i përket **sigurimit të një prove të re** e cila mund të çonte ERE-n, në një vendimmarrje ndryshe nga vendimmarrja e mëparshme.

Për sa më sipër, bordi i ERE-s:

Vendosi:

1. Refuzimin e kërkesës së shoqatës “AREA”, për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. ERE-s nr. 27, datë 16.02.2023 “Mbi çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 67, datë 08.02.2023”.
2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë shoqatën “AREA” Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi me publikimin në fletore zyrtare.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI